



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
"ISA BOLETINI"

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
Tel: +381-28535725/535727

Rektor i UMIB-it

Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 279/004

Dt 03.03.2017

Në bazë të nenit 48, pika 1.3, të Statutit të Përkohshëm, Senati i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", në mbledhjen e mbajtur më 2.3.2017, mori:

VENDIM

- I. Refuzohet si e pabazë ankesa e Vesel Islamit me nr. prot. 1672 të datës 30.12.2016, e paraqitur kundër raportit të Komisionit recensues për mospërzgjedhjen e tij, në bazë të konkursit të shpallur më 31.10.2016 të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini".
- II. Vërtetohet në tërësi raporti i komisionit recensues i shpallur në buletin nr. 9, në bazë të të cilit është shpallur njoftimi nga UMIB se: "Askush nuk i plotëson kriteret për pozitën një asistent për lëndët: Letërsi për fëmijë, Metodologji e leximit letrar dhe Histori e letërsisë kombëtare", në Fakultetin e Edukimit të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini".

Arsyetim

Universiteti i Mitrovicës ka shpallur konkurs për zgjedhjen e një asistenti për lëndët: Letërsi për fëmijë, Metodologji e leximit letrar dhe Histori e letërsisë kombëtare", në Fakultetin e Edukimit të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini".

Pas shpalljes së buletin nr 9 në ueb-faqen zyrtare të UMIB-it, ankimuesi Vesel Islami ka paraqitur ankesë me nr. prot. 1672, të datës 31.10.2016, me të cilin pretendon se i është bërë shkelje nga ana e komisionit recensues, i cili nuk ka shkruar raport për ankimuesin.

Senati i Universitetit, në mbledhjen e mbajtur më 2.3.2017, duke pasur parasysh propozimin e Komisionit për ankesa dhe parashtresa, konstatoi se propozimi i Komisionit recensues është në pajtim të plotë me nenin 153, pika 5 dhe nenin 159 të Statutit të UMIB-it, për arsye se kandidati është më i vjetër se 30 vjet (neni 159, pika 1.2) dhe Komisioni vlerësues bën vlerësimin e kandidatëve të cilët konsiderohen që kanë përmbushur kushtet për postin e ofruar (neni 153, pika 5). Në bazë të kësaj që u tha më sipër, Senati vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes në dorëzim, MASHT-it.

Vendimi t'i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Të përmendurit;
3. Fakultetit;
4. Zyrtarit ligjor.



Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Rektor i UMIB-it